URDHËR
Nr. 1025, datë 26.11.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PESTËS SË RUMINANTËVE TË VEGJËL TË SHFAQUR NË SHTETIN E BULLGARISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, e tranzitimit nga i gjithë territori i Republikës së Bullgarisë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë të vegjël dhe ruminantë të vegjël të egër;

b) materialit biologjik dhe embrioneve të pashoqëruara me test diagnostik PCR të rezultuar negativ, bashkëlidhur certifikata shëndetësore veterinare kryer 21 ditë para mbledhjes së tyre;

c) mishit dhe produkteve të mishit të patrajtuar termikisht minimalisht me një temperaturë 70°C për të paktën 30 minuta;

d) qumështit dhe produkteve të qumështit të patrajtuara termikisht minimalisht me një temperaturë 72°C për 15 sekonda (temperaturë e lartë me pasterizim me kohë të shkurtër HTST) e paaplikuar 2 herë;

e) miellit të mishit dhe miellit të gjakut, kockat pa dhjam, thundra, kthetra dhe brirë të patrajtuara termikisht minimalisht me një temperaturë 70°C për të paktën 30 minuta;

f) leshin, flokët të cilët nuk kanë pësuar trajtimet e mëposhtme:

i. larje industriale, e cila konsiston në zhytjen e leshit në një sërë banjash me ujë, sapun dhe hidroksid natriumi (sode) ose hidroksid kaliumi (potasium);

ii. depilimi kimik me anë të gëlqeres së shuar ose sulfurit të natriumit;

iii. tymosje me formaldehid në një dhomë të mbyllur hermetikisht për të paktën 24 orë;

iv. pastrim industrial, i cili konsiston në zhytjen e leshit në një detergjent të tretshëm në ujë të mbajtur në 60–70°C;

v. ruajtja e leshit në 4°C për katër muaj, 18°C për katër javë ose 37°C për tetë ditë.

g) lëkurën e papërpunuar dhe lëkurën e ruminantëve të vegjël të patrajtuar për të paktën 28 ditë me kripë (NaCl) që përmban 2% karbonat natriumi (Na_2CO_3);

h) trofetë e gjuetisë dhe preparate të destinuara për muze nga ruminantët e vegjël të papërpunuara, të pathara plotësisht dhe që kanë gjurmë të lëkurëve, mishit ose tendinave ose janë të padezinfektuar në mënyrë adekuate;

i) produktet me origjinë shtazore për përdorim farmaceutik ose kirurgjikal, të kafshëve të llojit ruminantë të vegjël, që nuk janë përpunuar për të siguruar shkatërrimin e virusit të pestës së ruminantëve të vegjël.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit ruminantë të vegjël, ruminantë të vegjël të egër, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe produkteve të mishit, qumështit dhe produkteve të qumështit, miellit të mishit dhe miellit të gjakut, kockat pa dhjam, thundra, kthetra dhe brirë, leshin, flokët, lëkurën e papërpunuar dhe lëkurën e ruminantëve të vegjël, trofetë e gjuetisë dhe preparate të destinuara për

muze nga ruminantët e vegjël, produktet me origjinë shtazore për përdorim farmaceutik ose kirurgjikal, të kafshëve të llojit ruminantë të vegjël.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj